

**KLINIKA PSIKOLOGJIKE
“BUTTERFLY”**

**URDHRI I PSIKOLOGUT
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Nr. — prot., datë 21.05.2019

Nr. 198 prot., datë 21.05.2019

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Sot më datë 21.05.2019, në Durrës, nënshkruhet ky memorandum bashkëpunimi ndërmjet palëve:

KLINIKA PSIKOLOGJIKE “BUTTERFLY”, përfaqësuar nga Administratori, Z. Elton Kuqja, me seli në Durrës, me nr. 27 Licence dhe NUIS L81704505B, në adresën: Rr. “Sefer Efendiu”, Objekt 22/11, Zona Kadastrale 8512, Durrës, në vijim i quajturi **Koordinatori Lokal**

Dhe

URDHRI I PSIKOLOGUT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, përfaqësuar prej Presidentes Znj. Valbona Treska, me seli në Tiranë, në adresën: “Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla 2, Nd. 26, Ap. 9, me Nr. Nipt: L71603455G, në vijim i quajtura **URDHRI** ose **Urdhri i Psikologut**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi është rregullimi i marrdhënieve midis Koordinatorit Lokal dhe Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë, me synim ofrimin e shërbimeve të përfaqësimit në nivel rajonal në funksion të lehtësimit të shërbimeve për anëtarët e Urdhrit të Psikologut.

Neni 2
Forma e bashkëpunimit

Bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi realizohet nëpërmjet:

- a. kryerjes së shërbimeve për anëtarët e Urdhrit në kuadër të shpërndarjes efektive të informacioneve që lidhen me ushtrimin e profesionit, mbledhjes dhe shpërndarjes së dokumentacionit specifik, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së ushtrimit të profesionit të psikologut në institucionet përkatëse rajonale dhe uljen e kostove për përfitimini e këtyre shërbimeve për anëtarët e Urdhrit në Qarkun Durrës.
- b. vendosjen dhe ruajtjen e marrdhënieve të Urdhrit me organet vendore dhe subjektet e tjera publike dhe private në rajon, me qëllim rritjen e ndikimit dhe faktorizimin e Urdhrit në rajon.
- c. organizimin e përbashkët të aktivitetave sociale dhe profesionale për anëtarët e Urdhrit në rajon.
- d. shkëmbimit periodik të relacioneve në lidhje me pasqyrimin e veprimtarisë së kryer gjatë zbatimit të këtij memorandumi.

Neni 3
Detyrimet e Koordinatorit Lokal

Koordinatori Lokal, merr përsipër kryerjen e detyrave të mëposhtme:

- a. Mbështetje për mbrojtjen e interesave të anëtarëve të Urdhrit të Psikologut të qarkut përkatës, në lidhje me nevojat dhe problematikat që ata ndeshin gjatë ushtrimit të profesionit të tyre, për të lehtësuar, për aq sa është e mundur, ushtrimin në mënyrë të pavarur dhe me etikë të lartë të profesionit të psikologut.
- b. Informimi i detajuar për çdo psikolog, i cili do të kryejë procedurat e anëtarësimit, licencimit, zhvillimit të praktikës profesionale, provimit të shtetit, kryerjen e trajnimeve të ndryshme, etj.
- c. Mbledhja e të gjitha dokumentave të nevojshme të psikologëve të qarkut përkatës për sa i përket procedurës së anëtarësim-liçensimit, si dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me Urdhrin, dhe përcjellja e tyre pranë Urdhrit të Psikologut.
- d. Shpërndarja për psikologët e qarkut përkatës të lejes së ushtrimit individual të profesionit (Licencave Profesionale) apo e çdo dokumentacioni tjetër të lëshuar nga Urdhri për anëtarët e këtij rajoni.
- e. Krijimi dhe ruajtja e marrëdhënieve të bashkëpunimit, brenda qarkut me institucionet e administratës shtetërore, organizma jo-qeveritare, si dhe me çdo subjekt tjetër publik apo privat, që ka qëllime të përbashkëta me Urdhrin e Psikologut.
- f. Pranimi i të gjitha ankesave të ardhura nga cilido person fizik apo juridik në drejtim të psikologëve dhe përcjellja e tyre pranë Urdhrit të Psikologut.
- g. Informimi i psikologëve të qarkut lidhur me vendimet dhe udhëzimet e Urdhrit të Psikologut, si me për aktet normative, misionin, synimin dhe funksionet e Urdhrit të Psikologut.

- h. Informimi periodik i Urdhrit të Psikologut lidhur me veprimtarinë e Koordinatorit Lokal.
- i. Nxitja dhe informimi i anëtarëve për shlyerjen e detyimeve financiare kundrejt Urdhrit të Psikologut
- j. Mbështetja për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive studimore e shkencore në fushën e psikologjisë në rajon.

Neni 4
Detyrimet e Urdhrit të Psikologut

Urdhri i Psikologut merr përsipër kryerjen e detyrave të mëposhtme:

- a. Të mbështesë koordinatorin lokal në çdo kohë, lidhur me çdo problematikë të lindur gjatë ushtrimit të detyimeve sipas këtij memorandumi, duke i krijuar të gjitha kushtet për kryerjen me sa më efikasitet të rolit të tij.
- b. Të përcjellë të gjitha informacionet e nevojshme tek Koordinatorit Lokal, për të mundësuar mirëfunkcionimin e ushtrimit të rolit të tij, përfshirë dokumentacionin e nevojshëm për këtë qëllim.
- c. Të pajisë me dokumentacionin administrativ të Urdhrit, të kerkuara nga Koordinatori Lokal, të cilat janë të nevojshme për të përm bushur detyrimet e këtij të fundit për zbatimin e këtij memorandumi.
- d. Të ofrojë asistencë të kualifikuar juridike e profesionale, sa herë kërkohet nga Koordinatori Lokal, në funksion të arritjes së qëllimit të këtij memorandumi.
- e. Të mbajë të informuar Koordinatorin Lokal me çdo ndryshim, vendim apo udhëzim të dhënë nga Urdhrit të Psikologut.

Neni 5
Parimi i vullnetarizmit

Detyrimet e marra përsipër nga palët do të kryhen mbi bazën e parimit të vullnetarizmit, pa detyre financiare reciproke.

Koordinatori nuk mund të hyjë në marrëdhënie me subjekte të tjera në emër të Urdhrit të Psikologut, nëse nga këto marrëdhënie lindin detyre financiare për Urdhrin, nëse nuk është i autorizuar specifisht për një gjë të tillë.

Neni 6
Ndryshimi i Memorandumit

Ky memorandum mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të shkruar të palëve ose nëpërmjet pranimit në mënyrë të shkruar ose elektronike të çdo propozimi të bërë nga palët.

Neni 7
Afati i Memorandumit

Ky memorandum lidhet për një afat të pacaktuar, deri në institucionalizimin e Zyrave Rajonale të Urdhrit të Psikologut në këtë rajon.

Palët mund të bien dakord në çdo kohë përfundimin e këtij memorandumi, duke njoftuar me shkrim palën tjetër të paktën 30 ditë përpëra.


Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje e lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 9
Hyrja në Fuqi

Memorandumi i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga palët dhe publikohet në faqet zyrtare të internetit të palëve.

Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, 2 (dy) prej të cilave depozitohen në Klinikën Psikologjike “Butterfly” dhe 2 (dy) të tjera pranë Urdhrit të Psikologut.

**KLINIKA PSIKOLOGJIKE
“BUTTERFLY”**

Z.ELTON KUQJA
Administrator

**URDHRI I PSIKOLOGUT
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Znj. VALBONA TRESKA
Presidente

